



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 , 17 shkronja r) dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 9 shkronja r), 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRGADITJEN E AGJENDËS PËR
VENDOSJEN E SHTATORES SË KOMANDANTIT LEGJENDAR "ADEM JASHARI"

Neni 1
Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për përgaditjen e agjendës për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar "Adem Jashari" me datë 28 nëntor 2017, në këtë përbërje:

1. Basri Hashani, Drejtor i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Bekim Zaskoku, Zyrtar i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Avni Olluri, Drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtar
4. Burim Rrustemi , Shef i Kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Komunës, anëtar
5. Visar Kozhani, Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar
6. Bukurie Zejnullahu , Zyrtare e lartë për Informim, anëtare
7. Mimoza Karameta, Zyrtare për Integritet Evropiane, anëtare

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi të përgatisë agjendën dhe të përkujdeset për mbarëvajtjen e procesit për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar "Adem Jashari" e cila planifikohet të finalizohet me datë 28 nëntor 2017 .

Përkritazi me detyrat e cekura Komisioni do ti raportoj Kryetarit të Komunës .

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 632-58840

Lipjan, më 30.10.2017

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

